

VENDIM
Nr.400, datë 11.7.2007

**PËR NDARJEN E FAKULTETIT TË BUJQËSISË DHE KRIJIMIN E TRI FAKULTETEVE,
NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 41 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndarjen e Fakultetit të Bujqësisë dhe krijimin e tri fakulteteve të reja në Universitetin Bujqësor të Tiranës, me këto emërtime:

- a) Fakulteti i Ekonomisë dhe i Agrobiznesit;
- b) Fakulteti i Bujqësisë dhe i Mjedisit;
- c) Fakulteti i Bioteknologjisë dhe i Ushqimit.

2. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i Universitetit Bujqësor të Tiranës.

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi, në vitin akademik 2007-2008.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha